

RAPORTI I TAKIMIT VJETOR TË KUVENDIT TË ANËTARËVE

Data dhe vendi	24 Janar 2015, Prizren (zyra e EC Ma Ndryshe)
Pjesëmarrësit	<i>Anëtarët:</i> Taulant Gutaj, Artnet Haskuka, Ajtene Krasnqi, Kreshnik Basha, Dren Marseli, Enver Batiu (kryesues i Kuvendit të Anëtarëve për vitin 2015), Aliriza Arënliu, Edon Mullafetahu. Flaka Siqeca, Besart Lumi dhe Venera Goxha i dërguan votat e tyre paraprakisht përmes emailit. Besar Haxhibeqiri për arsye objektive në moment të fundit ka anuluar pjesëmarrjen, ndërsa ka munguar edhe Mytahir Haskuka, i cili ka dërguar letrën e dorëheqjes nga anëtarësia. <i>Stafi i organizatës:</i> Hajrulla Çeku (drejtor ekzekutiv), Admir Istrefi (koordinatori i financave), Valon Xhabali (koordinatori programi)
Agjenda e takimit	Hapje e takimit dhe mirëseardhje <i>Miratimi i rendit të ditës</i> <i>Zgjedhja e kryesuesit të ri të Kuvendit të Anëtarëve</i> Prezantimi i raporteve 2014, diskutim dhe miratimi i tyre Prezantim i Planit 2015, diskutim dhe miratim Prezantim i Strategjisë 2015-2019, diskutim dhe miratim Rishikimi i dokumenteve të qeverisjes së brendshme të organizatës <i>Propozim ndryshimet për Statutin e Organizatës</i> Zgjedhja e drejtorit të ri ekzekutiv të organizatës Votimi për anëtarët e ri të organizatës Çështje operationale të organizatës Mbyllja e takimit

Hapje e takimit

Takimi u hap nga Enver Batiu, Kryesues i Kuvendit të Anëtarëve për vitin 2014. Rendi i ditës u miratua pa ndryshim. Për Kryesues të ri të Kuvendit të Anëtarëve u nominua dhe u votua unanimisht Kreshnik Basha, i cili do të mbajë këtë pozitë gjatë tërë vitit 2015.

Prezantimi, diskutimi dhe miratimi i raporteve të punës dhe financiare për vitin 2014

Rapori vjetor i punës për vitin 2014 u prezantua nga drejtori ekzekutiv i organizatës. Ky raport përfshin: projektet e realizuara gjatë vitit, iniciativat dhe aktivitetet e tjera, publikimet, partneritetet dhe të arriturat e punës një vjeçare. Pas raportit vjetor të punës, koordinatori i financave i organizatës e prezantoi raportin vjetor financiar. Ky raport përfshin: listën e projekteve dhe donatorëve bashkë me shumat e përkrahjes, të hyrat gjatë vitit 2014 në bazë të projekteve/donatorëve (236,157.86 EUR), shpenzimet detaje gjatë vitit 2014 (197,028.91 EUR) dhe gjendjen aktuale në xhirrollogarinë e organizatës në fund të vitit (44,616.24 EUR).

Prezantimi i raportit të punës dhe atij financiar u pasua me diskutim të anëtarëve të Kuvendit. Pas diskutimeve rreth të dy raporteve, anëtarët e Kuvendit votuan veç e veç për secilin prej këtyre raporteve. Me votat PËR të të gjithë anëtarëve prezent (dhe tre anëtarëve që i kanë dërguar votat e tyre përmes emailit), në votime të veçanta, u miratuan Raporti Vjetor i Punës 2014 dhe Raporti

Financiar 2014. Të dyja dokumentet (raportet), në formën e tyre përfundimtare të miratuara nga Kuvendi i Anëtarëve do të nënshkruhen nga Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve (në emër të Kuvendit të Anëtarëve) dhe drejtori ekzekutiv i organizatës (në emër të stafit të EC Ma Ndryshe) dhe do të publikohen në web-faqen e organizatës.

Prezantim i Strategjisë 2015-2019, diskutim dhe miratim

Dokumenti i zhvillimit strategjik të EC Ma Ndryshe për vitet 2015-2019 u hartua gjatë pjesës së dytë të vitit 2014, me ndihmën edhe të dy konsulentëve të jashtëm. Procesi i planifikimit strategjik ishte në thelb një ushtrim për të nxjerrë në pah identitetin e organizatës dhe e vendosjen e kornizave të veprimit bazuar në këtë identitet. Gjatë gjithë këtij ushtrimi, në të cilin morën pjesë një numër i konsiderueshëm personash, u analizuan të gjitha aspektet e veprimit të organizatës. Momenti në të cilin po hartohet ky dokument strategjik përfaqëson një orientim të ri të punës së EC-it, fillim i një periudhe të re në veprimtarinë e organizatës e cila synon të shndërrohet në shembullin më të mirë të organizimit komunitar në Prizren dhe Kosovë.

Sipas orientimit të ri strategjik, EC do të ketë orientim të tërësishëm komunitar, e cila do ta vendosë në pozitën e ndërmetësit për të siguruar pjesëmarrje të njëmendtë qytetarë në vendimmarrje. Ky dokument i ridefinon misionin, vizionin dhe vlerat e EC-it, duke reflektuar në punën e viteve të fundit dhe orientimet strategjike për vitet në vijim. Misioni i organizatës do të jetë: EC angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur organizim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë. Plani Strategjik i EC-it është i ndërtuar mbi tri qëllime strategjike të cilat brenda vetes kanë objektiva strategjike që përshkruajnë në detaje më të mëdha se si do të përmbush dhe të arrijë EC misionin dhe vizionin e saj, respektivisht:

- Qëllimi Strategjik 1 – Rritja e mundësive dhe njohurive për bashkëveprim me qytetarët,
- Qëllimi Strategjik 2 - Kuptim dhe avokim më i mirë rreth nevojave dhe alternativave për përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve,
- Qëllimi Strategjik 3 – Përmbushje e misionit duke menaxhuar me efikasitet resurset njerëzore dhe teknologjike.

Dokumenti Strategjik përcakton që duke filluar nga janari i vitit 2015, EC Ma Ndryshe do të funksionojë me këto tri programe:

1. Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizim i komunitetit)
Mobilizimi i komunitetit përbën thelbin e punës së EC-it. Identiteti i organizatës rrjedh nga angazhimi komunitar. Qyteti Gjithëpërfshirës do të jetë programi më i rëndësishëm i organizatës dhe do të përfaqësojë tiparin dallues të EC-it në raport me organizatat tjera të shoqërisë civile. Pjesë e këtij programi do të jenë veprimet që nxisin aktivizmin qytetar në nivel të grupeve të komunitetit (kryesisht lagjet urbane).
2. Qeverisja e mirë (monitorim dhe avokim)
Për t'u siguruar që qeveria lokale vepron në përputhje me kërkesat dhe interesat e grupeve të komunitetit dhe për të mbajtur gjallë presionin publik ndaj autoriteteve, programi i Qeverisjes së Mirë do të strukturohet rreth aktivitetit të monitorimit dhe rolin watchdog të organizatës. Monitorimi është një ndër tiparet më dalluese të punës së EC-it, ndërsa ai është dizajnuar në atë formë që do t'i ushqejë dy programet e tjera të organizatës me informacion të bazuar, të shpejtë dhe kredibil.
3. Hulimtim (prodhim i dijes)
Prodhimi i dijes do të jetë një nga sferat e angazhimit të përhershëm të organizatës. Duke ndërtuar mbi produktet e hulimtit të prodhuara në vitet e fundit, organizata do të ndërtojë një sistem të strukturuar të hulimtit dhe prodhimit të dokumenteve të

politikave. Programi i hulumtimit do të forcojë edhe më tutje kapacitetin prodhues të organizatës dhe do të përmirësojë kompetencën profesionale në fushat e ngushta të angazhimit.

Pas prezantimit të dokumentit strategjik, u diskutuan detaje të caktuara për zbatim efektiv të tij. Një nga sugjerimet e anëtarëve ishte përfshirja e listës së veprimeve të mundshme nën secilin qëllim strategjik dhe ndërtimi i një sistemi të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të strategjisë 2015-2019. Anëtarët u pajtuan me të gjitha aspektet e propozuara në këtë dokument, përfshi vizionin, misionin dhe vlerat, qëllimet dhe objektivat strategjike dhe riorganizim programor.

Me votat PËR të të gjithë anëtarëve prezent (dhe tre anëtarëve që i kanë dërguar votat e tyre përmes emailit), u miratuan Strategjia 2015-2019 e organizatës. Dokumenti, në formën e tij përfundimtare të miratuar nga Kuvendi i Anëtarëve do të nënshkruhet nga Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve (në emër të Kuvendit të Anëtarëve) dhe drejtori ekzekutiv i organizatës (në emër të stafit të EC Ma Ndryshe) dhe do të publikohet në web-faqen e organizatës.

Prezantimi, diskutimi dhe miratimi i Planit të Punës dhe Planit Financiar për vitin 2015

Plani i Punës për vitin 2015 u prezantua nga drejtori ekzekutiv i organizatës. Plani vjetor i punës është në harmoni me Strategjinë e re të organizatës, dhe i strukturuar në bazë të qëllimeve strategjike dhe riorganizimit programor të organizatës. Plani i Punës 2015 parasheh:

- Vazhdimin e zbatimit të disa projekteve të cilëve u ka mbaruar mbështetja financiare, për të siguruar vazhdimësi dhe qëndrueshmëri të punës dhe ndikimit,
- Qasjen strategjike të thellimit (profesionalizimit të mëtejshëm) në projektet aktuale dhe potencialisht, zgjerimit të tyre edhe në komunat e tjera (pasi që ato janë pilotuar në Prizren),
- Të rritet puna hulumtuese e organizatës, e cila nga viti 2015 do të zbatohet në kuadër të programit të tretë, krahas mobilizimit të komunitetit dhe qeverisjes së mirë,
- Realizimin e nëntë (9) projekteve, përfshi projektet aktuale të organizatës dhe disa të reja.

Pas prezantimit të planit të punës, koordinatori i financave i organizatës e shpalosi planin financiar për vitin 2015. Sipas këtij plani me shtatë kategori të gjëra buxhetore, organizata synon të realizojë buxhet vjetor prej 221,920.00 EUR gjatë vitit 2015. Pjesë e Planit Financiar 2015 është edhe lista e burimeve të të hyrave (projektet, donatorët dhe shumat).

Prezantimi i planit të punës dhe planit financiar për vitin 2015 u pasua me diskutim të anëtarëve të Kuvendit. Diskutimi u përqendrua në nevojën për konsolidimin e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të punës së organizatës, përfshi projektet, programet, qëllimet strategjike dhe planet vjetore. Pas diskutimeve rreth të dy dokumenteve, anëtarët e Kuvendit votuan veç e veç për secilin prej tyre. Me votat PËR të të gjithë anëtarëve prezent (dhe tre anëtarëve që i kanë dërguar votat e tyre përmes emailit), në votime të veçanta, u miratuan Plani i Punës 2015 dhe Plani Financiar 2015. Të dyja dokumentet, në formën e tyre përfundimtare të miratuara nga Kuvendi i Anëtarëve do të nënshkruhen nga Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve (në emër të Kuvendit të Anëtarëve) dhe drejtori ekzekutiv i organizatës (në emër të stafit të EC Ma Ndryshe) dhe do të publikohen në web-faqen e organizatës.

Rishikimi i dokumenteve të qeverisjes së brendshme të organizatës

Anëtarët i diskutuan propozimet për plotësim/ndryshim të Statutit të organizatës në këto nene: 1.6, 5.3, 7.3, 7.5, 7.6 dhe 7.7. Pas diskutimeve dhe me votat PËR të të gjithë anëtarëve prezent (dhe tre anëtarëve që i kanë dërguar votat e tyre përmes emailit), u morën këto vendime për plotësim/ndryshim të Statutit të organizatës:

- Vendoset adresa e re e organizatës,

- Kuvendi i Anëtarëve zgjedh vetëm Drejtorin Ekzekutiv, ndërsa ky i fundit emëron dy anëtarët tjerë të Bordit Udhëheqës. Deri tani, Kuvendi ka zgjedhur të gjithë anëtarët e Bordit Udhëheqës. Ky parim do të vlejë edhe për shkarkimin para përfundimit të mandatit,
- Bordi Udhëheqës mund të përbëhet nga anëtarët e organizatës. Deri tani, ka qenë e detyrueshme që Bordi Udhëheqës të përbëhet nga anëtarët e organizatës,
- Mandati i Drejtorit Ekzekutiv dhe Bordit Udhëheqës, nga dy bëhet tre-vjeçar,
- Nuk u miratua propozimi për më së shumti dy mandate të Drejtorit Ekzekutiv. Drejtori Ekzekutiv dhe anëtarët tjerë të Bordit Udhëheqës mund të zgjedhen për mandate të njëpasnjëshme.

Zgjedhja e drejtorit të ri ekzekutiv të organizatës

Drejtori Ekzekutiv i organizatës, Hajrulla Çeku, i cili në fund të vitit 2014 ka përfunduar mandatin e parë në këtë pozitë, ishte i nominuari i vetëm për Drejtor Ekzekutiv. Me votat PËR të të gjithë anëtarëve prezent në takim, Hajrulla Çeku u zgjodh Drejtor Ekzekutiv për një mandat të ri tre-vjeçar.

Votimi për anëtarët e ri të organizatës

Shtatë persona ishin të nominuar për t'u anëtarësuar në organizatë. Konfirmimi i anëtarësimit të tyre në EC u bë gjatë takimit, ku për secilin person të nominuar për anëtarësim, Kuvendi i Anëtarëve votoi veç e veç (për konfirmimin e anëtarësimit kërkohet shumica, 50% + 1 e votave përkrahëse të anëtarëve prezent në takimin e Kuvendit të Anëtarëve. Me votat PËR të të gjithë anëtarëve prezent në takim, në votime të veçanta, personat e mëposhtëm u konfirmuan si anëtarë të ri të organizatës:

- **Nadire Thaçi Kryeziu**, Gazetare në Radio Prizrenit, aktualisht në studimet Master në Trashëgimi Kulturor dhe Turizëm
- **Fahri Musliu**, Gazetar i pensionuar, ish-korrespondent i RKT-së në Beograd, dhe drejtor i shoqatës Bekim Fehmiu
- **Antogina Shestan**, Aktiviste e shoqërisë civile (të drejtat e personave me nevoja të veçanta) dhe drejtore e Organizatës së Personave me Distrofi Muskululare të Kosovës
- **Enesa Xheladini**, Arkitekte, ish staf i organizatës EC Ma Ndryshe në projekte të trashëgimisë kulturore
- **Refet Bushati**, Afarist, Kryetar i bashkimit të shoqatave afariste të Prizrenit ZES
- **Ernesta Jadrashi Qata**, Professore në Fakultetin e Arkitekturës, eksperte e trashëgimisë kulturore
- **Ajete Kërçeli**, Aktiviste e të drejtave të njeriut dhe pjesë e organizatës Peer Educators Network në Kosovë

Ndërkohë, nga anëtarësia është larguar Mytaher Haskuka. Për shkak të angazhimit në parti politike gjatë vitit 2014 dhe pozitës së deputetit në Kuvendin e Kosovës, Mytaher Haskuka ka dërguar letër për dorëheqje nga anëtarësia. Me votat PËR të të gjithë anëtarëve prezent në takim u miratua dorëheqja dhe largimi i Mytaher Haskuka nga anëtarësia e organizatës.

Diskutime dhe vendime të tjera

- Nga viti 2015, do të mbahen së paku dy takime vjetore të Kuvendit të Anëtarëve, një në fillim të vitit (për mbylljen e vitit paraprak) dhe një në mes të vitit për të vlerësuar ecurinë e punës,
- Anëtarët e organizatës do të njoftohen për punën e organizatës përmes raporteve të rregullta narrative dhe financiare të cilat do t'i pranojnë nga drejtori ekzekutiv,
- Sigurimi i cilësisë së hulumtimeve dhe raporteve (publikimeve) duhet të jetë prioritet për punën e organizatës. Ngritja dhe zhvillimi i programit të hulumtimeve është kusht i domosdoshëm për rritjen e profesionalizmit dhe kompetencës hulumtuese,
- Në çdo moment duhet të sigurohet baraspeshë adekuate mes shpenzimeve për aktivitete dhe për burime njerëzore.